



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 789/ Prot.

Tiranë, më 22.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1616, datë 06.03.2013.

SHOQËRISË “MINERALUNIT” SH.P.K
Rrajcë, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “MINERALUNIT” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1616, datë 06.03.2013, për mineralin Hekur-Nikel, në objektin “Përroi I Shpellës”, bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.467, datë 25.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.789, Prot, datë 26.01.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1616, datë 06.03.2013, për mineralin Hekur-Nikel, në objektin “Përroi I Shpellës”, bashkia Librazhd, qarku Elbasan, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit për vitin 2020-2021.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1616, datë 06.03.2013, për mineralin Hekur-Nikel, në objektin “Përroi I Shpellës”, bashkia Librazhd, qarku Elbasan që shoqëria Juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1616, datë 06.03.2013, për mineralin Hekur-Nikel, në objektin “Përroi I Shpellës”, bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

